

Analizë e Raportit Vjetor të Operatorit të Agjencisë së Aviacionit Civil të Kosovës (AAC)

Analizë Politikash

/2020



Analizë e Raportit Vjetor të Operatorit të Agjencisë së Aviacionit Civil të Kosovës (AAC)

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Prill 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje.....	2
Baza Ligjore	3
Objektivat strategjike të AAC-së	3
Siguria	4
Qasja në dokumente publike.....	4
Organizimi dhe burimet njerëzore	4
Auditimi.....	5
Licencat	6
Buxheti.....	6
Koordinimi ndërinstitucional.....	6
Të tjera.....	6

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të AAC për vitin raportues 2019. Kjo analizë përkon me preokupimin e vazhdueshëm të INDEP me çështjen e agjencive të pavarura dhe instrumenteve mbikëqyrëse së punës së tyre. Raporti i agjencive të pavarura mbetet instrumenti i vetëm që aktualisht Kuvendi i Republikës e ka për të balancuar pavarësinë me llogaridhënjën, një objektivë që ka qenë në vazhdimësi sfidë ndaj agjencive të pavarura.

Bazuar në ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil të Kosovës, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës duhet të raportojë në Kuvend të Kosovës me specifikat e mëposhtme:

15.2 Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Drejtori i Përgjithshëm duhet të përgatisë, përfundojë dhe sigurojë Bordit, Ministrisë, Qeverisë dhe Kuvendit, një raport gjithëpërfshirës vjetor i çili siguron informata të bollshme për vitin e shkuar kalendarik lidhur me:

- *organizimin, veprimtarinë, personelin dhe nivelin e rrogave të AAC,*
- *prokurimet, menaxhimin financiar dhe çështjet buxhetore të AAC*
- *të gjitha ankesat administrative, kontestet (konfliktet) dhe procedurat e paraqitura ose të zhvilluara*
- *gjatë vitit të shkuar kalendarik; të gjitha vendimet dhe masat mbi çështjet ekzekutive, rregullore ose të licencimit të AAC.*
- *Ky raport vjetor duhet të përmbajë, në formë të shtojcës, planin e punës dhe atë financiar për vitin e shkuar kalendarik.*

Përveç kërkesave të parapara me ligj për raportim, INDEP e ka parë të nevojshme që AAC të raportojë rreth punës që ka bërë duke u bazuar në masë më të madhe në përgjegjësitë dhe kompetencat siç janë të parapara në Ligjin për Aviacionin Civil të Kosovës. Duke raportuar në detaje rreth plotësisht të përgjegjësisë dhe kompetencave të parapara me ligj, AAC jep një pasqyrë më të qartë rreth punës së bërë gjatë një viti. INDEP e sheh të nevojshme përfshirjen e detajeve, me theks të veçante në specifikat e punës së Bordit dhe menaxhmentit të AAC, dhe përmbushjen e planit të veprimit të paraparë për vitin raportues. Për këtë qëllim është harmonizuar Manuali për raportim të agjencive të pavarura në Kuvendin e Kosovës. Në bazë të këtij manuali, pikat shtesë për të cilat do të duhej të raportonte AAC-ja në bazë të mandatit të saj janë:

6.1.1. Këshillat dhe propozimet e ofruara nga AAC për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil.

6.1.2. Statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejeve të aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre.

6.1.3. Informatat e shpërndara për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së.

6.1.4. Avionët civil të regjistruar dhe ata të larguar nga Regjistri i Avionëve Civil.

6.1.5. Inspektimet e kryera në platformë dhe kontrollimet në vend.

6.1.6. Bllokimet e Avionëve të Rrezikshëm.

6.1.7. Dispozitat ndësbkimore të shqiptuara.

Të gjeturat e raportit

INDEP vlerëson se përkundër disa të dhënave të rëndësishme të paraqitura këtë vit në raport, raportit ende i mungojnë të dhëna substanciale për ta treguar punën e bërë të AAC-se gjatë vitit 2019, dhe raporti ende përdoret për promovim të Autoritetit të Aviacionit Civil e jo për raportim gjithëpërfshirës dhe informata të detajuara mbi punën e AAC-së gjatë vitit. Duhet cekur se përsëri në këtë raport kemi hasur

në disa pjesë teksti të kopjuara nga raportet e viteve të kaluara, fakt i cili na bën të dyshojmë mbi validitetin e këtij raporti edhe këtë vit. Por përkundër raportimit të mangët në pjesë të ndryshme të raportit, në raportin vjetor të këtij viti ka pasur edhe ndryshime që do të mund të karakterizoheshin si pozitive

Baza Ligjore

Fillimisht, si karakteristikë ndryshe, në raportin e këtij viti ceket publikimi i dy udhëzimeve administrative për lehtësim të të udhëtuarit në Aeroportin e Prishtinës si për shtetasit e Kosovës, ashtu edhe për të tjerë. Problem ky që ka shqetësuar sidomos udhëtarët shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët kanë udhëtuar përmes aeroportit të Prishtinës, ka qenë problemi i të kuptuarit të gjuhëve të huaja që kanë të bëjnë me rregullat e sigurisë në bord të aeroplanit në gjuhën e kuptueshme për shumicën e pasagjerëve në atë aeroplan. Zgjidhja e këtij problemi ka qenë e domosdoshme tash e shumë kohë, andaj duke u bazuar në këtë problem, AAC ka nxjerrur një Urdhëresë Administrative, qëllimi i së cilës është përcaktimi i transmetimit të detyrueshëm të rregullave të sigurisë në bord të aeroplanit edhe në gjuhën e kuptueshme për shumicën e pasagjerëve në bord të aeroplanit, të një fluturimi, në pajtim me ligjin për gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës¹. Sidoqoftë Urdhëresa Administrative tjetër që përmendet në raport, përveç që ceket që është publikuar, nuk ceket si dhe për cka shërben e madje as se si mund të caset nga lexuesit.

Poashtu në pjesën raportuese të Bazës Ligjore të raportit, këtë vit përveç përshkrimit të qëllimeve të Ligjit për Aviacionin Civil², theks të veçantë i'u vihet edhe ndryshimeve që duhet bërë në Ligj, tipar pozitiv ky, që vlen të përmendet. Por në raport përveç se ceket se kush ka të drejtë të inicioj ndryshimin e ligjit, nuk ceket qëllimi kryesor për të cilin po kërkohet ky ndryshim. Ndër tjerash në raport do të duhej të tregohej se cilat nga dispozitat e ligjit duhet të ndryshohen e cilat të përmirsohen, arsyen se pse duhet të ndryshohen këto dispozita, dhe gjithashtu çfarë dëmsh kanë shkaktuar dhe çka mund të shkaktojnë në të ardhmen në rast se nuk ndryshohen, pasi që nëse për hartuesin e raportit dihet se çka duhet të ndryshohet, për lexuesin është e mjaft e pakuptueshme.

Objektivat strategjike të AAC-së

Në raportin e vitit 2019, AAC flet edhe për objektivat e këtij institucionit. Ky institucion objektivat strategjike të tyre, i shpreh në mënyrë shumë sipërfaqësore e të përgjithshme. Vërejmë se AAC-ja, ka bërë një plan strategjik 5 vjeçar, 2019-2023, dhe se në këtë periudhë kohore AAC, thekson se duhet t'i arrij vetëm 5 objektiva, që sipas INDEP janë shumë të përgjithshme dhe të pa mjaftueshme. P.sh pika e tretë e këtyre objektivave flet për 'Lidhjen e marrëveshjeve teknike rajonale'. Në këtë pikë duket qartë mos konkretizimi i objektivave, pasi që do të ishte më korrekte të cekeshin se cilat marrëveshje pretendohet të lidhen dhe cilat janë dobitë e institucionit duke lidhur atë marrëveshje.

Këto objektiva strategjike të AAC-së, që gjenden në raport të po këtij institucioni, duhet të detajizohen dhe të bëhet një planifikim vjetor i tyre. INDEP konsideron të arsyeshme që në shpalljen e këtyre objektivave nje vjecare të jenë të përfshira ndër tjerash edhe, investimet strategjike.

¹ Urdhëresë Administrative (AAC) Nr. 02/2019; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë, Dhjetor 2019.

² Ligji NR 03/L-051 për Aviacionin Civil; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; Prishtinë, Qershor 2008.

Siguria

AAC-ja nuk ka raportuar mbi testin e sigurisë, mjaft të rëndësishëm për të cilën kanë shkruar shumë medie³, test ky që lidhet me fushën e sigurisë në aeroport dhe që faktikisht ka rezultuar i suksesshëm. Testi u realizua nga autoritetet e sigurisë në Kosovë, përmes një bombe të simuluar, e cila arriti të vërehet nga skanerët e aeroportit. Ky test ka ndodhur një ditë para se në aeroport të ateronte një aeroplan ushtarak amerikan, në mënyrë që të testohet siguria. Gjithashtu në të njëjtën ditë autoritetet e sigurisë kanë provuar edhe futjen e disa gjësendeve të pa lejuara në aeroplan përmes disa personave, por ata persona janë vërejtur nga autoritetet e sigurisë së Aeroportit. Ky test konsiderohet të jetë i vështirë dhe raportimi i duhur mbi të do të përmirësonte reputacionin e AAC-së në fushën e sigurisë.

Në raport përmendet që numri i ndodhive të raportuara në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, është rritur shumë krahasuar me vitin e kaluar, rritje kjo që shënon numrin e ndodhive të dytin më të lartë këto 12 vitet e fundit, pas vitit 2014. Gjithsesi sipas AAC-së kjo ngritje jodomosdoshmërisht tregon ulje të sigurisë në aviacionin civil, madje AAC e paraqet si tipar pozitiv, duke deklaruar që “Rritja graduale e numrit të ndodhive të raportuara nga viti në vit nuk paraqet rënie të nivelit të sigurisë në aviacionin civil, por mund të jetë rezultat i vetëdijesimit dhe raportimit të përpiktë nga pjesëmarrësit në industrinë e aviacionit”. Kjo informatë e paraqitur si e tillë në raport është mjaft e mangët.

Dukuri pozitive e raportuar, sa i përket sigurisë në ANP-së gjatë vitit 2019, ka qenë edhe Ushtrimi gjithëpërfshirës për reagim në emergjencë, i organizuar nga LKIA. Ky ushtrim, qëllim kryesor kishte përgatitjen e reagimit sa më profesional të punonjësëve të aeroportit, në raste emergjente. Gjithashtu në këtë ushtrim u sprovua koordinimi për aktivizimin e të gjitha resurseve të aeroportit. Për më shumë, ushtrimi rezultoi i suksesshëm pasi që simulimi ishte mjaftë serioz dhe në këtë ushtrim morën pjesë edhe anëtarë të AAC-së, ASHNA-së, FSK-së, KFOR-i, MPB, KHAIA etj.

Qasja në dokumente publike

AAC në këtë raport tregon për revistën e përmuajshme që ndihmon lexuesin që të informohet me zhvillimet që ndodhin në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe gjithashtu për industrinë e aviacionit në përgjithësi. Revista në fjalë është një zhvillim i rëndësishëm që kontribuon në rritjen e transparencës dhe të afërsisë së njerëzve të interesuar me zhvillimet që ndodhin në AAC. Gjatë analizës së raportit, vërejmë se kjo revistë që do të duhej publikuar çdo muaj, gjatë vitit 2019 është publikuar vetëm tri herë gjithsej.⁴ Kjo neglizhencë në lidhje me publikimin e kësaj reviste flet shumë për jokorrektësinë dhe papërgjegjësinë e AAC-së ndaj lexuesve të rregullt.

Veçori pozitive që vlen të ceket, kur theksi është tek qasja në dokumente publike është fakti se gjatë vitit 2019 në AAC janë pranuar 6 kërkesa për qasje në dokumente publike. Në raport thuhet se të gjitha kërkesat janë përmbushur brenda afatit ligjor. Një praktikë e tillë duhet ndjekur si shembull nga secili institucion i vendit për shkak se ky problem është i dukshëm thajse çdo ditë.

Organizimi dhe burimet njerëzore

³<https://reporteri.net/lajme/bombe-ne-aeroportin-e-prishtines-si-u-testua-siguria-nje-dite-para-kthimit-te-110-kosovareve-nga-siria/>; Qasur për herë të fundit më: 16.05.2020.

⁴<https://caa.rks-qov.net/category/buletini/>; Qasur për herë të fundit më: 16.05.2020.

Sa i përket personelit, Agjencia e ka cekur se edhe këtë vit si vitet e kaluara, vazhdon të ketë deficit në staf, edhe pse këtë vit duke krahasuar numrin e punonjësëve nga raporti i vitit të kaluar, vërejmë se kjo agjenci ka rritur numrin e punëtorëve për një person. Sipas AAC-së ky është problem që vetëm po shkon duke u thelluar, edhe pse në përmbushjen e planit të punës për këtë vit nuk duket të ketë penguar stafi i limituar, për shkak se AAC ka treguar se ka përmbushur 91% të planit të punës.

AAC gjithashtu ka një Zëvendësdrejtor i cili nuk është i paraparë me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil të Republikës së Kosovës. AAC udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil. Drejtori i përgjithshëm i ka të gjitha kompetencat në udhëheqjen e Autoritetit, në bazë të ligjit dhe AAC sipas këtij ligji nuk parashihet që të ketë Zëvendësdrejtor. Sidoqoftë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka zgjedhur në janar të vitit 2017 Zëvendësdrejtorin duke u bazuar në nenin 6.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil i cili flet për kompetencat e Ministrin por që askund nuk i referohet organizimit të brendshëm të AAC-së dhe nenit 14.3. Për INDEP, zgjedhja e zëvendësdrejtorit të tanishëm është e kontestueshme, duke u bazuar në Ligj e gjithashtu edhe në nevojë për atë pozitë.

Problem tjetër me të cilin AAC është përballur në vitin që po e lëmë pas ka qenë greva e punëtorëve dhe kontrollerëve ajror në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ngjarje kjo me rëndësi të madhe, e që në raport të AAC-së përmendet vetëm shkurtimisht greva e kontrollerëve e nuk përmendet fare ajo e punëtorëve tjerë. Pra mungon informacion bazik në lidhje me këtë ngjarje. Sipas raportit të AAC-së kjo grevë thuhet se është mbajtur për disa orë, ndërsa realisht mediet kanë raportuar se greva ka vazhduar me ditë të tëra⁵. Përveç kësaj në raport, mungon informacion i qartë në lidhje me kërkesat e kontrollerëve ajror dhe nëse janë plotësuar apo jo këto kërkesa, duke pasur parasysh se grevistët kanë kundërshtuar Ligjin për paga, i cili sipas tyre cenon dhe dëmton pavarësinë e këtij institucioni. Gjë tjetër me rëndësi e që në raport nuk ceket është se si pasojë e grevës kanë shtyer dhe anuluar shumë fluturime në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Mungesa e këtij informacioni të rëndësishëm cënon rëndë kredibilitetin e kësaj agjencie dhe vë në bën të dyshojmë nëse raporti është gjithëpërfshirës dhe objektiv.

Auditimi

Në raportimin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA), vetëm shkurtimisht tregohet se ku është fokusuar auditimi këtë vit dhe se ZKA ka konfirmuar se “...pasqyrat financiare të AAC-së për vitin 2018 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale”. INDEP konsideron se një fjali e tillë për ta përmbyllur raportimin e auditimit financiar nga ZKA është e pamjaftueshme. Poashtu, nuk jepen të dhëna se kush kanë qenë auditorët e brendshëm dhe se cilat kanë qenë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre.

Ndërkaq gjatë raportimit mbi mbikëqyrjen e ASHNA-s thuhet se gjatë auditimit të sigurisë në periudhën shkurt-mars “... u identifikuan 12 gjetje dhe 1 observim, ndërsa 18 gjetje mbeten të hapura nga auditimet e mëparshme...” dhe gjithashtu “...gjatë auditimit në muajin qershor gjithsej u identifikuan 23 gjetje dhe 1 observim...”. Njëjtë vazhdon edhe për auditimin e tretë, që është mbajtur në periudhën tetor-nëntor dhe ku gjithsej janë identifikuar 11 gjetje të reja dhe janë mbyllur 26 gjetje nga auditimet e kaluara. Në fund të cdo raportimi të auditimit tregohet se detajet në lidhje me gjetjet individuale i janë dorëzuar ASHNA-s. Këtë praktikë AAC vazhdon ta ndjekë edhe këtë vit. AAC në raport vjetor, përveç numrit të gjetjeve dhe

⁵https://telegrafi.com/vazhdon-edhe-sot-greva-e-punetoreve-te-aeroportit/?fbclid=IwAR2tIcllJDëF271m7SV1VzB37Y1hcc_c8F7_91fMgQHYB6klkCTztmHNp64/; Qasur për herë të fundit më: 16.05.2020.

dorëzimin e tyre tek ASHNA duhet të tregojë më shumë për gjetjet dhe rëndësinë e tyre pas secilit auditimit si dhe masat e propozuara nga ASHNA për adresimin e këtyre gjetjeve.

Licencat

AAC në raport vjetor duhet të jap informata më të detajizuara në statistika rreth licencave, certifikatave dhe lejeve të aprovuara, duke përfshirë këtu pezullimet dhe revokimet e tyre. INDEP vlerëson se AAC-ja duhet të japë të dhëna të hollësishme për licencat që i lëshon dhe ato që i refuzon detaje, si p.sh sa prej kërkesave për licencim janë refuzuar si dhe arsyet për refuzimet potenciale. Në të njëjtën linjë, nuk ka ndonjë të dhënë për pezullimet dhe revokimet potenciale të licencave.

Buxheti

Një ndër sfidat që AAC prezanton në raport, tash e disa vite është buxheti i pamjaftueshëm, i cili po vazhdon t'i ndahet këtij institucioni. AAC, përveç se vlerëson se mungesa e buxhetit po vështirëson në masë të ndjeshme operimin e rregullt të institucionit, ku gjithashtu cek edhe vështirësitë që buxheti shkakton në profesionalizimin e stafit, mbajtjen e kurseve, që do t'iu mundësonte në këtë rast inspektorëve ndjekjen e trajnimeve përditësuese, të detyrueshme sipas standardeve ndërkombëtare për të mbajtur kredencialet e stafit, nuk jep informata të tjera se si dhe në çka konkretisht ka ndikuar buxheti i pamjaftueshëm në operimin e rregullt të kësaj agjencie dhe në realizimin e mandatit që ka. Arsyetimet tjera të dhëna janë të përgjithshme, andaj INDEP konsideron se raporti duhet të përfshijë arsyet konkrete që kanë penguar në përmbushjen e planit të punës dhe operimin e rregullt, dhe ato arsye të shërbejnë si arsye serioze dhe si apel ndaj institucioneve përgjegjëse, për ta zgjidhur problemin e buxhetit 'të pa mjaftueshëm' që po vazhdon ti ndahet këtij institucioni.

Koordinimi ndërinstitutional

AAC gjithashtu raporton se ka bashkëpunuar ngushtë me institucione përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës, në mënyrë që i tërë sistemi rregullativ dhe mbikqyrës i shtetit, të funksionoj i koordinuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. AAC në këtë raport tregon se ka pasur takime brenda dhe jashtë shtetit. Në raportimin për bashkëpunimin me Komisionin Parlamentar të ZHEITZHR, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, KHAIA-në, Zyrën e BE-së në Kosovë, KFOR-in, Doganën e Kosovës, Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencinë për Informim dhe Privatësi, raporti shfaq shumësinë e bashkëpunimeve të lartpërmendur, por nuk përmenden efektet dhe dobijtë e këtyre takimeve. INDEP vlerëson se në vend se ky raport të tregojë për vendmbajtjen dhe datat e takimeve, do të ishte e duhur të raportohesh për rezultat e takimeve dhe bashkëpunimeve. Psh tek bashkëpunimi me KFOR-in, AAC dështon të tregojë për rezultatet e takimit, aty më shumë ngjanë në kërkesë dhe gatishmëri për bashkëpunim, se sa në bashkëpunim. Raportimi në këtë mënyrë, tregon një mungesë përmbajtjeje e gjithashtu një mungesë serioziteti që shkakton dëm narrativës së përgjithshme të raportit mbi punën e AAC-së.

Të tjera

AAC ndër tjerash ka raportuar edhe mbi finalizimin e programit nxitës për të cilën ende nuk jepen detaje të hollësishme. Në raport flitet që programi nxitës përmban 5 produktë, por nuk tregon se çfarë lloj produktesh janë ato. AAC flet për rritjen e numrit të udhëtarëve si rezultat i këtij programi, por nuk

tregon se cilat janë rezultatet në rritjen e numrit të udhëtarëve dhe numrit të fluturimeve për secilin program nxitës. Flitet gjithashtu edhe për dy destinacione të reja por nuk tregohet se për cilat destinacione është fjala.

Për më tepër Drejtorit të përgjithshëm i është dhënë vlerësimi nga MIT, se AAC nuk ka bazë ligjore për të aprovuar një program të tillë nxitës. AAC dështon të raportoj më gjerësisht rreth këtij refuzimi të programit nga ana e MIT dhe planet që kanë kjo agjenci për ta funksionalizuar këtë program.

Vlen të ceket se në raport tek programi nxitës flitet për një Memorandum Shpjegues, për grupin punues ndërinstitucional, qëllimi i cilit është fuqizimi i programit nxitës në ANP “Adem Jashari”. Raporti nuk detajizon objektivat e atij memorandumit, por vetëm përmend sipërfaqësisht ato dhe gjithashtu nuk tregohet mënyra si duhet qasur në atë memorandum.

Shqetësim tjetër që INDEP vazhdimisht e shfaq, është edhe tarifa e sigurisë⁶ prej 2 eurove, që i vendoset çdo udhëtar që udhëton me fluturime komerciale nga Kosova. Në raportin vjetor të këtij viti ceket se të hyrat e kësaj takse të sigurisë nuk shfrytëzohen vetëm për mbulimin e shpenzimeve operative të AAC-së por edhe për qëllime tjera⁷, por përsëri nuk përmendet opsioni i uljes së kësaj tarife. INDEP në vazhdimësi ka apeluar që të ulet kjo tarifë për shkak të parimit të ekuivalentit në përcaktimin e taksave publike.⁸ Nëse këto taksa duhet të mblidhen për arsye të caktuara më lartë siç AAC thekson, atëherë domosdoshmërisht kjo taksë duhet të ulet. Lartësia e cmimit të taksës duhet të varet nga përmbushja e qëllimit për të cilin mblidhet e jo të shfrytëzohet për mbushje të buxhetit.

Përfundime dhe rekomandime

- Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2019 është i mangët në informata dhe një pjesë e konsiderueshme e të dhënave të rëndësishme janë shmangur nga raportimi, edhe pse këtë vit mund të vërejmë disa ndryshime pozitive.
- Në raport përvec se ceket që Ligji duhet ndryshuar, duhet të ceket edhe cilat dispozita duhet të ndryshohen ose përmirësohen.
- INDEP vlerëson se duhet të krijohet një plan më i specifikuar i objektivave strategjike që do të ndërmerret agjencioni në vitin vijues.
- AAC dështon të raportojë përsëri në mënyrë të detajuar grevën e punëtorëve dhe kontrollerëve ajror, gjithashtu nëse kërkesat e këtyre grevistëve janë marrur parasysh apo jo.
- INDEP konsideron se raporti duhet të përfshijë arsye konkrete që kanë penguar në përmbushjen e planit të punës dhe operimin e rregullt, dhe ato arsye të shërbejnë si arsye serioze dhe si apel ndaj institucioneve përgjegjëse, për ta zgjidhur problemin e buxhetit ‘të pa mjaftueshëm’ që po vazhdon të ndahet këtij institucioni.
- Ende problem vazhdon të jetë mungesa e të dhënave mbi vërejtjet dhe rekomandimet qoftë në tabela ose në formë të shkruar, që janë marrë nga auditimi i kësaj agjencie.

⁶<http://www.airportpristina.com/themes/simpleweb-startit/assets/files/Business%20Activities%20-%20Airport%20Price%20List%20SQ.pdf>, Pika 9, Qasur për herë të fundit më: 15.05.2020.

⁷ Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, (2019), Raporti Vjetor për vitin 2019, faqe 104, Prishtinë: AAC.

⁸ Për më tepër shih publikimin e INDEP: “Taksat e dedikuara në Kosovë – çka po marrim në këmbim të pagesës?”, në: <https://goo.gl/GfhGyt>, Qasur për herë të fundit, më:17.05.2019.

- Në raport ka mungesë e të dhënave specifike për licencat e lëshuara apo revokimet a pezullimet potenciale të licencave.
- Institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të ketë një plan të qartë të bashkëpunimit me institucione vendore ose ndërkombëtare. Vazhdimi i praktikës (takime pa rezultate) rrezikon seriozitetin e takimeve të liderëve të institucioneve.
- Qytetarët vazhdojnë të paguajnë tarifën e sigurisë, për qëllimin e sigurisë, ani pse niveli i tyre tejkalon shumëfish qëllimin për të cilën kjo tarifë mblidhet. AAC në raport përmend se tarifa përvec se për mbulimin e shpenzimeve operationale të AAC-së, shfrytëzohet edhe për qëllime tjera, por nuk përmendet domosdoshmëria e uljës së tarifës pikërisht për këtë arsye.